REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 273-295/19
Datë/Datum. 21.06.19
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

AKT PËRCJELLËS

Për:	Menaxherin e Prokurimit Komuna e Pejës	Kopje:	Paneli Shqyrtues - OSHP
Prej:	Agim Sheqiri – Ekspert Shqyrtues i prokurimit.		
Lënda:	Raporti i Ekspertit Shqyrtues, lidhur me ankesën me Nr. 273 dhe 2 95/19 të parashtruar nga OE."DWH Kosova" dhe "Ageo &Co" shpk		
Datë	21.06.2019		

Bazuar në nenin 114 të Ligjit Nr. 04/L-042 i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, ju njoftojmë me raportin lidhur me ankesën e datës 03.06.2019 dhe 10.06.2019 me nr. protokolli . 273 dhe 295/19 të parashtruar nga OE."DWH Kosova" dhe "Ageo &Co"shpk -Prishtinë për aktivitetin e prokurimit: **Blerja e instrumentit matës për nevojat e Drejtoratit për Kadastër dhe Gjeodezi** " me nr. prokurimi **635-19-1164-1-2-1 i realizuar nga Komuna e Pejës (KP)**

AK, është i thirrur që pas marrjes së raportit të Ekspertit Shqyrtues lidhur më këtë kërkesë, të veprojë sipas kërkesave të nenit 115 të LPP-së.

Të bashkangjitur gjeni raportin e Ekspertit Shqyrtues.

Ti dorëzohet:
- OE ankues
- Autoritetit Kontraktues- Komuna e Pejës
- Panelit Shqyrtues – OSHP

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosova
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

		12.06.2019	21.06.2019
Nënshkrimi i ekspertit		data e autorizimit të ekspertit.	data e dorëzimit të raportit

N. 105, LPP - Baza ligjore e shqyrtimit

Me datën: 03.06.2019 dhe 10.06.2019 OE. "DWH Kosova" dhe "Ageo &Co" shpk –Prishtinë parashtrojnë ankesë për aktivitetin e prokurimit: **"Blerja e instrumentit matës për nevojat e Drejtoratit për Kadastër dhe Gjeodezi"** me nr. prokurimi **635-19-1164-1-2-1 I realizuar nga Komuna e Pejës (KP)**

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

Operatori Ekonomik Ankues "OE. "DWH Kosova" dhe "Ageo &Co" shpk

*Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues sipas OE"*Ageo &Co" shpk

- Neni 1 Qëllimi
- Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti
- Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi-
- Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve
- Neni 60 Kriteret për Dhënien e Kontratës
- Neni 72 të LPP-së

Deklarate detale mbi faktet dhe argumentet

Ju njoftojmë se është e paqëndrueshme arsyeja e eliminimit, sepse kërkesë e FDT-së tek neni 9.1&9.2 i FDT-së ka qenë si në vijim "Specifikimi teknik i detyrueshëm", pra nuk ka qenë kërkesë e dosjes që specifikimet teknike të ofrohen nga prodhuesi, por vetëm specifikimet teknike dhe ne i kemi të nënshkruara dhe të vulosura specifikimet teknike (si i kanë parashikuar teparamasa).
Ndërsa dëshmi e kërkuar dokumentare është kërkuar "Deklaratë e O.E (e nënshkruar dhe e vulosur) mbi pranimin e specifikimeve teknike të detyrueshme të dhëna nga A.K."

Gjithashtu ne si operator ekonomik e kemi ofruar deklaratën ku e konfirmojmë pranimin e specifikimeve teknike, prandaj rezulton se ne i kemi plotësuar kërkesat e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë.

Se si janë formuluar kërkesat e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë, është përgjegjësi e autoritetit kontraktues, mirëpo ne, ashtu siç është kërkuar i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë.

Për çdo kërkesë tjetër, e cila nuk është kërkuar në FDT, nuk mund të eliminohemi sepse neni 56.3 iLPP-së parasheh qartë "Tenderuesi, gjatë procedurave të hapura, ose kandidati, gjatë procedurave të kufizuara dhe procedurave konkurruese me negociata, nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkese ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit".

Në vendimin e dt:31.05.2019 për refuzim të kërkesës për rishqyrtim, autoriteti kontraktues nuk jep asnjë sqarim më tepër se në letrën standarde për tenderues të eliminuar por na jep disa shembuj se si duhet të jetë deklarata për specifikime teknike, mirëpo ne ju sqarojmë se nuk është kërkuar ndonjë formë e veçantë e deklaratës, prandaj deklaratat si të tilla duhet të merren parasysh pavarësisht se në çfarë forme janë ofruar.

Përfundimisht ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë konform nenit 59 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët, sipas nenit 60 të LPP-së dhe po ashtu jemi diskriminuar në kundërshtim me nenin 7 të LPP-së, sepse ne jemi ofertues i përgjegjshëm dhe me çmim më të ulët.

Duke pasur parasysh nenin 1 dhe 6 të LPP-së, autoritet kontraktues është dashur të shfrytëzojë të gjitha dispozitat e LPP-së, edhe nëse kapasur nevojë për sqarime shtesë është dashur të shfrytëzohen nenin 59.2 dhe 72 të LPP-së, për të ardhur në një përfundim të saktë dhe real, sidomos kur kemi parasysh çmimin tonë të ofruar dhe mundësinë e ruajtjes së fondeve publike në
lidhje me këtë aktivitet të prokurimit, e dihet se se autoritetet kontraktuese janë të thirrur për të shfrytëzuar fondet në mënyrë racionale, ekonomike, efikase dhe duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit.Duke u bazuar në dëshmitë dhe faktet që u cekën më lartë, kërkojmë nga OSHP-ja, që të merr:

VENDIM APROVOHET, ankesa e OE"AGEO & CO " SH.P.K si e bazuar, dhe lënda të kthehet në
RIVLERËSIM dhe gjatë rivlerësimit, ekzaminimi. vlerësimi dhe krahasimi i ofertave të bëhet në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të LPP-së.

Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi të detyruar të vazhdojmë procedurën ligjore në institucionet tjera kompetente

Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues sipas OE "DWH Kosova"

- Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 Shkelje
- LPP 04/L-042, Neni 1, Neni, 6, Neni 7,
- Rregullat dhe Udhëzuesi operativ per prokurimet publike A01, date 10.04 2019

Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Me date 24.05.2019 AK ka nxjerre ne sistem rezultatin e vlerësimit, ku propozon fitues OE Geo-Tech dhe s'kualifikon OE DWH – KOSOVA
Me date 28.05.2019 Ora 14 - 16:00 ne jemi te AK për tu njohur me dosjen e tenderit, ku veme re shkelje flagrante te ligjit (shiko ne vazhdim)
Me date 29.05.2019 ne bëjmë kërkesën per rishqyrtim
Me date 31.05.2019 AK refuzon kërkesën për rishqyrtim me motivacionin qe ne jemi "jashtë afatit 5 ditor qe parasheh ligji", duke ju referuar Udhëzimit Operativ per prokurimet publike A01, date 10.04.2019
AK edhe pse i referohet këtij udhëzimi, e shkel ketë udhëzim dy here:
Shkelja pare: Udhëzimi operativ, ditën e nxjerrjes se shpalljes, e konsideron diten "0" dhe pastaj pas kësaj dite fillon numërimi 5 ditor.
Pra AK lexon ne mënyre desherore dhe jo ligjore udhëzimin e siper permendur
Shkelja 2: Afati kohor fillon nga dita me njohjen e dosjes, pasi persa kohe qe OE nuk ka qasje ne dosjen e tenderit nuk mund te beje dot kerkese apo pranese. Ligjvenesi kur i ka dhëne mundësinë OE qe te njihen me dosjen e ka menduar realisht si mundesi dhe jo si "pamundesi". Keshtu qe afati 5 ditor (dita "0") fillon me datën 28
Nëse AK "ka besuar" vërtet qe data 28.05.2019 është dita e fundit, lind pyetja: si ka mundësi qe AK na ka caktuar diten e fundit dhe orarin fundor per tu njohur me dosjen e tenderit? Pasi dita sipas ligjit mbaron ne ora 16:00 dhe si rrjedhoje, kur ne ndodheshim ne ambientet e AK per tu njohur me dosjen, AK "e dinte qe afati qe ai na ka dhene neve, nuk permbante me kohe fizike per tu ankimuar
Pra sipas AK, "ligjvenesi paska pasur qëllime hileqare ne konceptimin e ligjit".
Jo nuk është kështu, ligjvenesi nuk ka mundësi te jete hileqar, pasi ai ka interes ne përdorimin efikas dhe transparent te fondeve publike. Vetëm kush kërkon te ketë qëllime te kundërta mund te interpretoje ligjin ne mënyrë te padrejte
Si do qe te jete ne cdo version qe te interpretohet ligji, ne jemi brenda afatit 5 ditor dhe AK me përgjigjen e saj rezulton qe nuk ka dhëne përgjigje
Duke vazhduar me tej ne kemi vene re shkelje te renda te ligjit, ku OE i shpallur fitues nuk i është nënshtruar fare procesit te vlerësimit, pasi është parakualifikuar (shiko protokollin e vlerësimit.
Pra OE parashpallur fitues është shpallur fitues pa u verifikuar dhe vlerësuar oferta e tij, pasi kjo rezulton e njohur me pare.

Kjo tregon qarte, qe ka pasur komunikim ndërmjet personave te AK dhe OE ne fjale ne rruge jashtë-tendore, pra jashtëligjore.

Procesi i prokurimit:

Data e njoftimit për kontratë: 13.03.2019
Lloji i procedurës së aplikuar:.....Procedurë e hapur
Lloji dhe vlera e kontratës së publikuar:..... Kontratë për furnizim me vlere te mesme
Vlera e parashikuar e kontratës:..... 20.000.00 €
Kriteri për dhënie të kontratës(N.52)..... tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët.
Afati i fundit për dorëzimin e ofertave. 08.04.2019
Data e hapjes së ofertave 08.04.2019
Data e përfundimit të vlerësimit të ofertave 24.05.2019
Njoftimi i vendimit nga AK ..... me datë 24.05.2019 është bërë njoftimi i vendimit dhe për kontratë është rekomanduar OE."Geo Tech"shpk me çmim prej 19.370.00 Eor
Data e kërkesës për rishqyrtim.....OE "Ageo &co" parashtron kërkesë për rishqyrtim me datë 25.04.2019 , AK përmes vendimit me date 31.05.2019 e refuzon Kërkesën për Rishqyrtim të pa bazuar, ndërsa OE me datë 29.05.2019 DWH-Kosova"parashtron kërkesë për rishqyrtim dhe AK përmes vendimit me date 31.05.2019 e refuzon kërkesën për rishqyrtim të pa bazuar

Kriteret për kualifikim:

II.2.1) Kërkesat e përshtatshmërisë: 1. Deklaratë nën betim – Operatori ekonomik duhet ti përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë në pajtim me Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, Neni 65 duke përdorur formën në Aneksin 2. 2. Administrata Tatimore e vendit tuaj të themelimit, se ju nuk jeni me vonesë për pagimin

e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit përpara dorëzimit të tenderit.

3. Vërtetimin nga Gjykata themelore -Një formular ekstrakt nga "regjistri gjyqësor"apo, në mungesë të kësaj, një dokumente ekuivalent të lëshuar nga një autoritet kompetent gjyqësor apo administrativ i shtetit të themelimit të tenderuesit ku dëshmohet për Seksioni II. FLETA E TË DHËNAVE të Tenderit (FTD) të dosjes se tenderit te Pranueshmëria e Operatorëve Ekonomik, (shiko dosjen e tenderit pjesën 6.4

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

Evidenca 1: Deklaratë nën betim -duhet të dorëzohet në origjinal, e nënshkruar dhe e vulosur nga OE.

Evidenca 2: Një vërtetim i nënshkruar nga Administrata Tatimore - duhet të dorëzohen vetëm nga tenderuesi fitues, para publikimit të dhënies së kontratës- origjinal.

Evidenca 3: Vërtetimin nga Gjykata themelore duhet të dorëzohen vetëm nga tenderuesi fitues, para publikimit për dhënie të kontratës

III.2.2) Përshtatshmëria profesionale

1. Kërkesa: Certifikatë e regjistrimit të biznesit ,regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe/ose të korporatës në vendin e juaj te themelimit.
2. Kërkesa: Certifikatë e numrit fiskal .
3. Kërkesa: Certifikatë e TVSh-së.

Dëshmia e kërkuar dokumentare

Evidenca 1 Certifikata e regjistrimit të biznesit (kopje).
Evidenca 2 Certifikata e TVSH-kopje.
Evidenca 3 Certifikata e numrit fiskal-kopje

III.2.3) Kapaciteti ekonomik dhe financiar:
Kërkesa 1 Operatori ekonomik duhet ti ofrojë dëshmi të kënaqshme Autoritetit Kontraktues se qarkullimi vjetor i Operatorit Ekonomik,gjat tre vite të shkuara nga data e publikimit të (Njoftimit për Kontrat) duhet te jet jo më pak se 40.000.00 Euro.

Dëshmi
Dëshmia 1 Raporti bankar (vërtetim) apo ndonjë dëshmi tjetër zyrtare financiare qe dëshmon qarkullimin financiare për tri vitet të shkuara nga data e publikimit të (Njoftimit për Kontratë

III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional:
Kërkesa 2 Specifikimi teknik i detyrueshëm
Dëshmia e kërkuar dokumentare:
Dëshmia 2 Deklaratë e O.E (e nënshkruar dhe e vulosur) mbi pranimin e specifikimeve teknike të detyrueshme të dhëna nga AK

Regjistri i ofertuesve sipas procesverbalit të hapjes publike

Nr	Operatorët Ekonomik	Vendi	Çmimi €
1	"DWH-Kosova "	Prishtinë	10,797.00
2.	"DWH Albania"	Tiranë	10,856.00
3.	"Geo Tech"	Fushë Kosovë	19,370.00
4.	'Ageo&Co"	Prishtine	16,240.00

Komisioni vlerësues pranë AK:

Autoriteti Kontraktues për vlerësimin të ofertave ka caktuar komisionin në përbërje si në vijim:

1. Shkemb Kastrati – Kryetare e komisionit
2. Adhurim Kasapi – Anëtare e komisionit
3. Milot Gashi – Anëtare i komisionit

Raporti i komisionit vlerësues:

Komisioni i vlerësimit i trajton të gjitha ofertat në aspektin administrativ ,teknik dhe profesional, dhe sipas rezultateve finale OE DWH Kosova dhe "Ageo&Co" nuk i kualifikohen për vlerësim përfundimtar për arsye se nuk ofrojnë deshmi se plotësojnë specifikacionin teknik . Arsye e vetme e refuzimit është mungesa e dëshmive për specifikacion teknik dhe lidhur me ketë AK i ka njoftuar të dy OE ankues.

Përgjigjeje në pretendimet ankimore të Operatorëve Ekonomik ankues :

Sqarim Hyrës:

OE. "DWH Kosova " me date 24.05.2019 e ka pranua njoftimin për eliminim ndërsa me datë 29 .05.2019 e parashtron Kërkesë për Rishqyrtim tek Autoriteti Kontraktues , mirëpo Kërkesa e tij refuzohet e pa bazuar për arsye se AK konsideron se nuk është parashtruar ne afatin e përcaktuar kohor pasi qe sipas rregullave dita e fundit për parashtrim të Kërkesës për Rishqyrtim ka qenë data 28.05.2019 pasi qe data 24.05.2019 ka qenë ditë e premte.

Përgjigjeje në pretendimet ankimore të OE.DWH Kosova

Eksperti Shqyrtues ka analizuar pretendimet ankimore dhe në bazë te vlerësimeve dhe analizave të bëra vlerëson se AK Operatorin Ekonomik ankues e ka trajtuar ne mënyrë të barabitë me të gjithë OE tjerë pjesëmarrës në tender .

Arsyeja refuzimit të Kërkesës për Rishqyrtim është e drejtë me vet faktin se afati i rregull

kohor për parashtrim ka qenë data 28.05.2019 pasi që njoftimin për eliminim OE e ka pranuar me date 24.05.2019 që ka qenë ditë e premte , dhe sipas rregullave afati kohor për përllogaritje ka filluar ditën e njoftimit për eliminimin.

Arsyet e eliminimit nga AK për OE "DWH Kosova kanpqë shumë konkrete , madje ne pretendime ankimore nuk mohohen arsyet e eliminimit lidhur me specifikimet teknike

- Ne specifikim teknik është kërkuar qe numri i kanaleve t e jete 450 ndërsa sipas ofertës pajisja ka 432 kanale.
- Memoria e brendshme është kërkuar të jete 30 GB ndërsa OE ankues ka ofruar memorie 8 GB,
- Nuk ofron sqarime lidhur me mundësin e ngarkim /shkarkimi te të dhënave ,
- Nuk ofron të dhëna për matje te pjerrtësisë etj.

Sipas vlerësimeve të Ekspertit vlerësimi lidhur me OE "DWH Kosova " nga AK ka qenë në përputhje me rregullat e LPP-së.

Gjithashtu Eksperti Shqyrtues konsideron se eliminimi i OE "Ageo&co" ka qenë i drejtë nga ana e AK-së për arsye se OE në fjale nuk ofron deklarate se përmbush specifikimet teknike

Tek kriteret kualifikuese Autoriteti Kontraktues e ka lenë mundësin qe OE përmes Deklaratës se nënshkruar dhe te vulosur të zotohen-deklarohen lidhur me përmbushjen e specifikacionit teknik , gjë qe nënkupton se mos zotim përmes deklaratës siq është kërkuar atëherë operatoret ekonomik do te eliminohen

Në vendimin e kërkesës për rishqyrtim AK në mënyrë të qartë OE "Ageo&co" i ka dhenë arsyen e eliminimit, që për mendimin e Ekspertit Shqyrtues ka qenë vendim i drejtë pasi që shumë qarte e ka theksuar e deklarata OE (e nënshkruar dhe vulosur) e zëvendëson aneksin 1 që ka të bëjë me specifikacionin teknik , pasi që përmes kësaj deklarate OE ofertues merr përsipër obligimin se furnizimi do te kryhet sipas kërkesave të AK-s[

Shkeljet e konstatuara të LPP-së

AK gjatë zbatimit të këtij aktiviteti të prokurimit vlerësimin e ofertave e ka ber ne përputhje të plotë me kërkesat e përcaktuar ne dosje te tenderit, dhe bazuar ne vlerësimin e AK-së , Eksperti Shqyrtues e konsideron te drejtë vendimin e AK-së për eliminim të OE ankues.

Mendimi i Ekspertit Shqyrtues

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, Eksperti Shqyrtues vlerëson se ankesat e OE ankues janë të pa bazuara dhe me ketë rast i rekomandon Panelit Shqyrtues që vendimi i AK-së të mbet në fuqi, për faktin se pretendimet ankimor nuk konsiderohen të bazuara nga an e Ekspertit Shqyrtues .